



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 29 nëntor 2024

Njoftim për shtyp

Lëvizjet më të rëndësishme në bilancin pagesor¹ në tremujorin e tretë të vitit 2024

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, në transaksionet aktuale me jorezidentë është realizuar një suficit prej 263,3 milionë eurove, si pasojë e suficitit të bilanci i të hyrave sekondare dhe në këmbimin e shërbimeve. Te transaksionet financiare me jorezident janë realizuar hyrje neto mbi bazën e investimeve direkte, ndërsa daljet neto mbi bazën e kredive tregtare, valutave dhe depozitave, investimeve të portofolit dhe huamarrjeve.

Komponentët bazë të bilancit pagesor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në milionë euro)

	viti aktual				viti paraprak				ndryshimet tremujore		ndryshimet vjetore		ndryshim agregat	
	T.1 2024	T.2 2024	T.3 2024	T.1-T.3 2024	T.1 2023	T.2 2023	T.3 2023	T.1-T.3 2023	milionë euro	%	milionë euro	%	milionë euro	%
Llogaritë rrjedhëse	-190.4	-104.9	263.3	-32.0	78.6	-126.7	229.1	181.0	368.2	...	34.2	14.9	-213.0	...
Mallra	-816.1	-740.3	-632.3	-2,188.7	-620.5	-596.4	-634.0	-1,850.9	108.1	-14.6	1.7	-0.3	-337.8	18.3
Shërbime	303.1	243.0	366.4	912.5	254.3	14.5	292.9	561.6	123.4	50.8	73.5	25.1	350.9	62.5
Hyrje primare	-196.9	-193.2	-197.8	-588.0	-183.0	-184.4	-189.6	-557.0	-4.6	2.4	-8.2	4.3	-31.0	5.6
Hyrje sekondare	519.4	585.7	727.0	1,832.2	627.8	639.7	759.8	2,027.3	141.4	24.1	-32.8	-4.3	-195.1	-9.6
Llogaria kapitale	0.0	0.5	-0.3	0.3	0.2	-0.5	-0.5	-0.8	-0.8		0.3		1.1	
Llogaria financiare	-182.6	-63.0	272.9	27.2	75.6	-119.8	256.5	212.3	335.9		16.4		-185.1	
<i>Komponenta më të rëndësishme:</i>														
Investimet direkte	-268.8	-209.3	-237.0	-715.1	-129.5	-119.7	-40.1	-289.3	-27.7		-197.0		-425.9	
Krijimi neto i mjeteve	219.9	17.1	55.2	292.2	214.7	130.1	168.1	512.9	38.1		-112.9		-220.7	
Kapital vetanak	28.1	30.9	31.3	90.4	15.2	22.1	19.0	56.3	0.3		12.3		34.0	
Riinvestim të fitimit	4.8	2.6	5.2	12.7	1.3	1.3	1.3	4.0	2.6		3.9		8.7	
Instrumente të borxhit	187.0	-16.5	18.7	189.2	198.2	106.6	147.8	452.6	35.2		-129.1		-263.4	
Krijimi neto i detyrimeve	488.7	226.4	292.3	1,007.3	344.2	249.7	208.2	802.1	65.9		84.1		205.2	
Kapital vetanak	97.7	71.6	39.9	209.2	49.8	68.5	104.4	222.8	-31.8		-64.6		-13.6	
Riinvestim të fitimit	139.9	82.2	22.2	244.3	34.8	34.8	34.8	104.5	-60.0		-12.7		139.8	
Instrumente të borxhit	251.1	72.5	230.2	553.9	259.6	146.4	68.9	474.8	157.6		161.3		79.0	
Investime të portofolit	67.0	47.3	106.8	221.1	-438.5	20.0	414.9	-3.5	59.5		-308.2		224.6	
Valuta dhe depozita	174.3	89.2	140.3	403.8	124.0	120.1	268.1	512.2	51.2		-127.7		-108.4	
Huamarrje	23.0	-48.2	69.7	44.5	163.7	-174.2	-8.1	-18.5	117.9		77.7		63.0	
Kredi tregtare	115.2	43.1	199.8	358.2	84.9	-17.7	-69.8	-2.6	156.7		269.7		360.8	
Rezerva valutore	-291.9	15.4	-3.4	-279.9	266.7	52.3	-308.7	10.3	-18.8		305.3		-290.2	

...* Ndryshimi procentual është mbi 100

Shënim: Në llogarinë financiare shenja (-) shënon të hyra neto nga jashtë. Te rezervat valutore shenja (+) shënon rritje, derisa shenja (-) shënon uljen e mjeteve valutore. Në të dhënat për rezervat valutore janë përjashtuar ndryshimet e çmimeve dhe diferencat e kursit.

Burimi: BPRMV-ja.

Llogaria rrjedhëse

Suficiti në transaksionet rrjedhëse me jorezidentët në tremujorin e tretë të vitit 2024 prej 263,3 milionë euro është rezultat i hyrjeve neto të realizuara në të ardhurat dytësore dhe nga shkëmbimi i shërbimeve (727 dhe 366,4 milionë euro, përkatësisht), të cilat e tejkaluan deficitin e realizuar të shkëmbimi i mallrave (632,3 milionë euro) dhe në të ardhurat primare (197,8 milionë euro).

Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit, kur llogaria rrjedhëse shënoi deficit prej 104,9 milionë euro, përmirësime janë realizuar edhe në të ardhurat dytësore (për 141,4 milionë euro),



¹ Bilanci pagesor është një raport statistikor që përmbledh sistematikisht të gjitha transaksionet ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut me jashtë për një periudhë të caktuar kohore, përkatësisht, përmbledh transaksionet rrjedhëse, kapitale dhe financiare ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

shkëmbimi i shërbimeve (për 123,4 milionë euro) dhe te shkëmbimi i mallrave (108,1 milionë euro), përkundër përkeqësimit të lehtë të nënbalanci i të ardhurave primare (për 4,6 milionë euro).

Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit të kaluar suficiti në llogarinë rrjedhëse shënon rritje për 34,2 milionë euro, që kryesisht shpjegohet me rritjen e të hyrave neto të shkëmbimi i mallrave (për 73,5 milionë euro) dhe uljes së deficitit të shkëmbimi i mallrave (për 1,7 milionë euro). Përkeqësim shënojnë nënbalancet në të ardhurat dytësore dhe në të hyrat primare (32,8 dhe 8,2 milionë euro, përkatësisht).



Burimi: BPRMV-ja.

Llogaria financiare

Te transaksionet financiare me jorezidentë, në tremujorin e tretë të vitit 2024 janë realizuar hyrje neto të investimet direkte (237 milionë euro), ndërsa dalje neto janë realizuar të kreditë tregtare (199,8 milionë euro), valutat dhe depozitat (140,3 milionë euro), investimet e portofolit (106,8 milionë euro) dhe huamarrjet (69,7 milionë euro).

Në tremujorin e tretë, të investimet direkte janë realizuar hyrje neto prej 237 milionë euro. Analizuar sipas komponentave, arritjet e tilla janë rezultat i hyrjeve neto të borxhi ndërkompanive (211,5 milionë euro), fitimi i riinvestuar (16,9 milionë euro) dhe të kapitali vetanak (8,6 milionë euro). Nga fillimi i vitit deri në shtator, në bazë të investimeve direkte, janë realizuar hyrje neto në vlerë prej 715,1 milionë euro, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, paraqet rritje prej 425,9 milionë eurove.

Detyrimet e bazuara në investime direkte në tremujorin e tretë të vitit 2024² shënuan rritje prej 292,3 milionë euro, si rezultat i rritjes neto prej: borxhit ndërkompani (230,2 milionë euro), kapitalit vetanak (39,9 milionë euro) dhe fitimit të riinvestuar (22,2 milionë euro).

² Investimet direkte shfaqen në varësi të faktit nëse transaksionet financiare krijojnë një detyrim ndaj ose një kërkesë (mjete) nga jashtë.





Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Mjetet në bazë të investimeve direkte janë rritur për 55,2 milionë euro, shkaku i rritjes së kërkesave në bazë të: kapitalit vetanak (për 31,3 milionë euro), borxhit ndërkompani (për 18,7 milionë euro) dhe fitimit të riinvestuar (për 5,2 milionë euro).

Në tremujorin e tretë të vitit, detyrimet neto në bazë të investimeve të portofolit janë ulur për 106,8 milionë euro, kryesisht si rezultat i rënies së detyrimeve bazuar në letrat me vlerë të borxhit të emetuara më parë nga shteti dhe në një masë të vogël nga riblerja e eurobondeve vendase nga rezidentët. Njëkohësisht janë rritur kërkesat nga investimet e rezidentëve në letra me vlerë të huaj te kapitalit dhe të borxhit (14,7 milionë euro dhe respektivisht, 26 milionë euro).

Detyrimet neto bazuar në huamarrje janë ulur për 69,7 milionë euro kryesisht si rezultat i daljeve neto nga banka qendrore³ (38,3 milionë euro) dhe nga shteti (32,2 milionë euro), ndërsa në një masë më të vogël nga sektori "institucione tjera depozituese" (3,4 milionë euro), kundrejt hyrjeve neto nga sektoret tjera⁴ (4,2 milionë euro).



Burimi: BPRMV-ja.

Në periudhën janar - shtator 2024, hyrjet neto nga investimet direkte (715,1 milionë euro), si dhe rezervat valutore kanë mundësuar financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe daljet neto të realizuara në komponente tjera të llogarisë financiare.

Rishikimi i të dhënave

Të dhënat për bilancin e pagesave në këtë njoftim përmbajnë një rishikim të rregullt të të dhënave për periudhën janar - qershor 2024 me qëllim përmirësimin e cilësisë së tyre. Njëkohësisht, rishikimi i të dhënave kontribuoi në rënien e deficitit në llogarinë rrjedhëse për 11,5 milionë euro, kryesisht si rezultat i rritjes së suficitit të shkëmbimi të shërbimeve dhe në të ardhurat dytësore

³ Aktivitetet e Bankës Popullore për menaxhimin me rezervat valutore.

⁴ Sektorët tjerë përfshijnë: ndërmarrje tjera financiare, ndërmarrje jofinanciare, amvisëri dhe institucione joprofitabile të cilat ju shërbejnë



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

(4,2 milionë euro dhe 2,1 milionë euro, përkatësisht) dhe rënia e deficitit të shkëmbimi të mallrave dhe nënbilanci të të ardhurave primare (për 4,2 milionë euro dhe 1 milionë euro, përkatësisht).

Në llogarinë financiare rishikimi ka sjellë rritje të detyrimeve neto për 13,6 milionë euro, kryesisht si rezultat i rritjes së hyrjeve neto në investimet direkte (për 22 milionë euro), me rritje të daljeve neto në kreditë tregtare (për 11.4 milionë euro).

Për shkak të rishikimit të të dhënave, ka pasur një ulje të gabimeve dhe lëshimeve për periudhën janar – qershor 2024 për 25,1 milionë euro.

Informacione shoqëruese

Seri kohore të të dhënave: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për bilancin pagesor
http://www.nbrm.mk/platen_bilans-al.nspix

Shpjegime metodologjike: http://www.nbrm.mk/platen_bilans-al.nspix

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/kalendar_na_objavuvanje_na_podatoci-al.nspix

Bilanci pagesor tremujor: 28 shkurt 2025 (periudhë referuese, deri më dhjetor 2024).

Për pyetje të gazetarëve, Ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 103 (ose 110/108).